



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2024:244038

Datë: 20.02.2025

Numri i dokumentit: 06872486

CA.nr.1931/2025

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Halide Reka, kryetare e kolegjit, Malsor Kryeziu dhe Bujar Muzaqi, anëtarë të kolegjit, me bashkëpunëtoren profesionale Xhennet Shantir, në çështjen juridike kontestimore të paditëses - propozueses të sigurimit M.K nga Gjakova, rruga “ M.L”, nr.*, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Shpresa Bakija, avokate nga Gjakova, kundër të paditurit - kundërshtarit të sigurimit I.A nga Gjakova, me objekt kontesti njohja e të drejtës në pronësi në bazë të kontributit, me propozim për caktimin e masës së sigurimit, duke vendosur sipas ankesës së paditëses - propozueses të sigurimit, të paraqitur kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.****/**, të datës 27.11.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 14.02.2025, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditëses – propozueses të sigurimit M.K nga Gjakova, rruga “M.L”, nr.*, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.****/**, të datës 27.11.2024, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e atakuar C.nr.****/**, të datës 27.11.2024, e ka refuzuar në tërësi propozimin për caktimin e masës së sigurisë të paraqitur nga propozuesja e sigurimit M.K nga Gjakova, me të cilën ka kërkuar që të: *“caktohet masa e përkohshme dhe i NDALOHET të paditurit - kundërshtarit të sigurimit I.A nga Gjakova që të tjetërsoj apo ta ngarkojë palujtshëm në kontestuese njësia nr. *****-*****_*-****-**, pjesë e ndërtesës, me kulturë banesë, pronë private me sipërfaqe prej 113m2, ZK Gjakovë - qytet, që gjendet në rr “M.L” nr.* në Gjakovë , gjer në përfundimin definitiv të kësaj çështje kontestimore. Gjykatës i*

propozoj që me aktvendimin mbi masën e përkohshme të njoftohen Drejtoria për gjeodezi dhe pronë të K Gjakovë dhe të gjitha noteritë kompetente”.

Kundër këtij aktvendimi në afat ligjor ka paraqitur ankesë paditësja – propozuesja e sigurimit nëpërmjet përfaqësueses së autorizuar, duke e atakuar të njëjtin për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë, të ndryshoj aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë, ashtu që të aprovohet propozimi i propozueses së sigurimit ose lënda të prishet dhe të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

I padituri – kundërshtari i sigurimit nuk ka paraqitur përgjigje në ankesën e paditëses – propozueses të sigurimit.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar dhe shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e paditëses - propozueses të sigurimit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja – propozuesja e sigurimit me datë 06.09.2024, ka paraqitur propozim për caktimin e masës së sigurimit kundër kundërshtarit të sigurimit I.A, kurse me datë 21.10.2024 ka paraqitur padi për njohjen e të drejtës në pronësi në bazë të kontributit, me propozim për caktimin e masës së sigurimit, me kërkesë përshkruar detajisht në paragrafin e parë të arsytimit të këtij aktvendimi.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas propozimit të propozueses ka caktuar seancën dëgjimore, pas mbajtjes të së cilës ka nxjerrë aktvendimin e atakuar C.nr.****/**, të datës 27.11.2024, me të cilën e ka refuzuar si të pabazuar propozimin e propozueses së sigurimit për caktimin e masës së sigurimit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata e shkallës së parë ndër të tjera ka theksuar se, nga provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës, e duke vlerësuar pretendimet e palëve arriti në përfundim se sipas kushteve ligjore nga neni 297, par.1, pika a) dhe b), gjykata vlerëson se përkundër faktit se është përmbushur kushti nga pika a) bërja e besueshme e kërkesës apo të drejtës subjektive nuk është përmbushur kushti nga pika b) ekzistimi i rrezikut real që do të pamundësonte dukshëm realizimin e kërkesës së saj dhe atë bazuar në faktin se për subjektin - kundërshtarin e propozimit të sigurimit nuk u parashtua asnjë provë konkrete që do të provonte se ekziston mundësia reale që tani përderisa po trajtohet kjo çështje në procedurë gjyqësore apo në një të ardhme të afërt i njëjti ka ndër marrë veprime të cilat do të kishin për qëllim ndryshimin e gjendjes reale faktike ashtu që do të pamundësohej realizimi i kërkesës së propozueses, kjo për shkak se propozuesja e masës së sigurimit, përkundër faktit se propozimit ia ka bashkangjitur provat si: Certifikatën e pronësisë me numër të lëndës ***/24, njësia kadastrale P-*****-****-

*-***-**, Transaksionet bankare të datës 04.11.2019, Transaksionet bankare të datës 19.04.2022, si dhe SMS nga rrjeti social Viber (pa datë) dhe nga dëgjimi i vet propozueses në seancë dëgjimore, nuk e ka bërë të besueshëm ekzistimin e rrezikut se pa caktimin e masës së sigurisë do të mund të i pamundësohet apo vështirësohet dukshëm realizimi i kërkesës. Kjo gjykatë vlerëson se përkundër pretendimit të propozueses sa i përket ekzistimit të rrezikut për tjetërsimin e banesës, duke marrë për bazë edhe deklarimin e saj, kjo nuk paraqet rrezik real (në vetvete) pasi që nga vetë pohimi i saj flitet për një rrethanë të ardhshme e cila mund të jetë e pa sigurt, e në këtë drejtim rreziku duhet të ekzistojë dhe vlerësohet në raport me veprimet konkrete të ndërmarra në lidhje me pretendimet e propozueses së sigurimit për të cilën kërkohet të vendoset masa e sigurimit. Por, kjo nuk do të thotë që me ndryshimin e rrethanave në secilën fazë të procedurës, pala propozuese të mos ketë të drejtë të bëjë sërish propozim për caktimin e masës së sigurisë, me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të saj subjektive, pasi që një mundësi të tillë e lejojnë dispozitat ligjore të LPK-së. Andaj meqë për caktimin e masës së sigurimit kushtet e parapara me dispozitën e nenit 297 par. 1 pika a) dhe b) të LPK-së, duhet të plotësohen në mënyrë kumulative, çka në rastin konkret nuk është plotësuar kushti i dytë i paraparë në pikën b), ka vendosur që propozimin për caktimin e masës së sigurimit ta refuzojë si të pabazuar. Për mënyrën e vendosjes gjykata e shkallës së parë i është referuar dispozitës së nenit 297 paragrafi 1 pika a) dhe b), nenit 300, si dhe nenit 304 paragrafi 3 të LPK-së.

Gjykata e Apelit e Kosovës e pranon vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë në tërësi si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se sipas gjetjeve të gjykatës ankimore rezulton se aktvendimi i atakuar me ankesë nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), për të cilat Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK. Gjendja faktike rezulton të jetë vërtetuar plotësisht dhe në mënyrë të drejtë dhe aktvendimi i ankimuar nuk është përfshirë as me shkelje tjera thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, sipas pretendimeve ankimore të bëra nga pala ankuese.

Sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së dytë, gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka analizuar dhe vlerësuar të gjitha rrethanat përkatësisht faktet e çështjes, mbi bazën e të cilave ka krijuar një pasqyrë të qartë, nga e cila ka rrjedhë se propozimi për caktimin e masës së sigurimit nuk është i bazuar, përkatësisht nuk ka mbështetje ligjore.

Gjykata e shkallës së parë duke u bazuar në faktet e theksuara në arsyetim të aktvendimit të ankimuar rezulton të ketë pasur pasqyrë reale mbi gjendjen e çështjes, prandaj Gjykata e Apelit, vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë e ka aprovuar në tërësi, për arsye se edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate në rastin konkret në bazë të provave nga shkresat e lëndës të cilat janë administruar në seancën dëgjimore nga gjykata e shkallës së parë, si dhe në bazë të deklarimeve të palëve ndërgjyqëse rezulton se në rastin konkret nuk janë plotësuar kumulativisht kushtet ligjore për caktimin e masës së sigurimit sikur është parashikuar me dispozitën e nenit 297 paragrafi 1, pika (a) dhe (b) të LPK, konkretisht nuk është plotësuar kushti nga pika (b) e nenit të lartcekur.

Për caktimin e masës së sigurimit të kërkesëpadisë, sipas dispozitës së nenit 297 paragrafi 1 pika a) dhe b) të LPK-së, parashihet se duhet të plotësohen dy kushte kumulative. Kushti i parë është që propozuesi i sigurimit ta bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të drejtës së tij subjektive, ndërsa kushti i dytë është që të ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtare do të mund të pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo në ndonjë mënyrë tjetër me të cilën do të ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit.

Gjykata e Apelit e Kosovës vlerëson se ligjërisht masa e sigurimit të kërkesëpadisë çdoherë duhet të shërben për ruajtjen e një gjendje ekzistuese të gjërave, me ndryshimin e të cilave palës e cila ka propozuar caktimin e saj do të shkaktohej dëm i pariparueshëm dhe i pa kompensueshëm ose në një formë apo tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit, me çka në rastin konkret kur kemi parasysh shkresat e lëndës dhe provat e administruara si dhe vlerësimin që ju ka bërë gjykata e shkallës së parë, është mendim dhe vlerësim edhe i gjykatës ankimore se refuzimi i propozimit të paditëses për caktimin e masës së sigurimit nuk do të ndikon fare në vendosjen meritore të çështjes kontestuese, me çka rrjedhimisht edhe nuk e pamundëson apo vështirëson realizimin e kërkesës së saj në qoftë se kërkesëpadia lidhur me çështjen kryesore sipas padisë së ushtruar do të del si e bazuar.

Në rastin konkret paditësja – propozuesja e sigurimit edhe pse e ka bërë të besueshme të drejtën e saj subjektive - pra se e njëjta jeton së bashku me kundërshtarin e sigurimit në banesën kontestuese për të cilën kërkohet caktimi i masës së sigurisë, sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së dytë në bazë të shkresave të lëndës propozuesja e sigurimit gjykatës nuk i ka ofruar prova relevante për të argumentuar pretendimin e saj se kundërshtari i sigurimit ka ndërmarrë ndonjë veprim konkret në drejtim të tjetërsimit apo ngarkimit të paluajtshmërisë kontestuese si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar, e mbi bazën e të cilave veprime pastaj gjykata e shkallës së parë do të kishte mundësi që të vlerësonte ndryshe kushtin e dytë ligjor të kërkuar sipas dispozitës së nenit 297 paragrafi 1 pika b) të LPK-së, që i referohet rrezikut lidhur me dëmin eventual që mund të shkaktohej propozuesit të sigurimit si shkak i mos caktimit të masës së propozuar.

Pretendimi ankimor i paditëses – propozueses të sigurimit se aktvendimi i atakuar është marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, për Gjykatën e Apelit është pretendim i pathemeltë, ngase kjo gjykatë konsideron se dispozitivi i aktvendimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e dhëna në aktvendim, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Po ashtu në aktvendimin e atakuar gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme rreth mënyrës së vendosjes dhe ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare, ku një mënyrë e tillë e vendosjes sipas vlerësimit të gjykatës ankimore ka mbështetje në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe në ligj.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes sipas këtij aktvendimi ka pasur parasysh dhe ka vlerësuar edhe pretendimet ankimore të paditëses – propozueses të sigurimit rreth vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, për të cilat kjo gjykatë ka vlerësuar se janë tërësisht të pabazuara, pasi që me shikim në shkresat e lëndës dhe analizimin e aktvendimit të ankimuar konsideron se gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes sipas aktvendimit të ankimuar në bazë të fakteve

të theksuara në arsyetimin e aktvendimit rezulton të ketë pasur pasqyrë reale mbi gjendjen e çështjes duke vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike, ku me rastin e vlerësimit të kushteve qoftë sa i përket të drejtës subjektive, si dhe përkitazi me ekzistimin e rrezikut si kusht i dytë për caktimin e masës së sigurimit me të drejtë ka vlerësuar se propozuesja e sigurimit nuk ka argumentuar me asnjë provë konkrete se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së sigurisë do t'i pamundësohej apo vështirësohej dukshëm realizimi i kërkesës, përkatësisht ekzistimin e ndonjë rreziku konkret se kundërshtari i sigurimit me veprimet e tij do të tjetërsonte apo ngarkonte banesën kontestuese me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozueses së sigurimit. Andaj gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka refuzuar si të pabazuar propozimin e propozueses për caktimin e masës së sigurimit, të cilin qëndrim e përkrah edhe Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, me çka si shkak i vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit me rastin e vendosjes drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale.

Gjykata e Apelit pa u lëshuar në shpjegime të mëtejme të cilat mund të prejudikojnë vendosjen meritorë për themelësinë e kërkesëpadisë, jep vlerësimin se aktvendimi i atakuar është i drejtë dhe i ligjshëm, por faktin se me aktvendimin e atakuar është refuzuar masa e sigurimit të kërkesëpadisë nuk nënkupton se vendosja meritorë nuk mund të jetë ndryshe, pasi që vendosja meritorë është rezultat i të gjeturave të gjykatës në shqyrtim kryesor, ku shqyrtohen të gjitha faktet dhe provat për të gjitha kërkesat/pretendimet dhe kundërshtimet.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet tjera ankimore mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga të cekurat më lart, e në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 208 dhe 209 pika (b) e LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
CA.nr.1931/2025, me datë 14.02.2025.

Bashkëpunëtorja profesionale
Xhennet Shantir

Kryetarja e kolegjit,
Halide Reka